

Drejtuar: Operatorit ekonomik “2 T” shpk

Adresa: “Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksioni i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga “Njazi Meka” – “Grigor Perlecev” – “Niko Avrami” – “Spiro Cipi” – “Fitnete Rexha” “Myslym Keta” – “Skender Vila” – Lumi i Tiranës”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksioni i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga “Njazi Meka” – “Grigor Perlecev” – “Niko Avrami” – “Spiro Cipi” – “Fitnete Rexha” “Myslym Keta” – “Skender Vila” – Lumi i Tiranës”.

Fondi limit: 183,428,431 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, miratuar me VKB Nr. 84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.08.2017, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.31 datë 07.08.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Agri Connstruction” shpk &”Bajrami N” shpk**

NUIS K01725001F NUIS K02727202O

Vlera e ofertës = **150,989,533.40** (njëqind e pesëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre pikë dyzetë) lekë pa TVSH.

- 2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Glavenica” shpk &”Besta” shpk**

NUIS K17710805A NUIS J62903182B

Vlera e ofertës = **158,595,908** (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetë) lekë pa TVSH.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “2 T” shpk

NUIS K01731001M

Vlera e ofertës = **164,208,440.10** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e tetë mijë e katërqind e dyzetë pikë dhjetë) lekë pa TVSH.

4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = **179,761,683** (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Agri Connstruction” shpk &”Bajrami N” shpk

NUIS K01725001F NUIS K02727202O

- Operatori ekonomik ”Bajrami N” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 -2012 (e vlefshme)*. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)”, pasi afati i vlefshmërisë për këtë Çertifikatë ka mbaruar në datë 22.06.2017.
- Operatori ekonomik ”Bajrami N” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë PAS 99-2012 (e vlefshme)*. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO), pasi afati i vlefshmërisë për këtë Çertifikatë ka mbaruar në datë 22.06.2017.
- Bashkimi i operatorëve ekonomik “Agri Konstruksion” shpk & “Bajrami N” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton*”, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton vetëm 1 nga 2 kamionë të kërkuar.

2. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Glavenica” shpk &”Besta” shpk

NUIS K17710805A NUIS J62903182B

- Operatori ekonomik “Glavenica” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të*

akredituara për çertifikimin e punonjësve...” pasi për 1 (një) nga punonjësit teknik ndërtimi nga 2 (dy) të kërkuar nuk është paraqitur dëshmia e kualifikimit.

Operatori ekonomik “Besta” shpk (i cili në bazë të Kontratës së Bashkëpunimit Nr. 1652. Rep, Nr. 612. Kol, datë 21.08.2017, do të kryejë 80 % të punimeve), nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve...”* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për punonjësit sa më sipër cka bie në kundërshtim edhe me të Nenit 74, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar),

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “2 T” shpk**, me adresë: **Adresa: “Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5, Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **164,208,440.10** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e tetë mijë e katërqind e dyzetë pikë dhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skenderbej”, Nr. 1, kod i postar 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **179,761,683** (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 08.09.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.